



PULSI PUBLIK -IX-

Prill 2015

Përpiluar nga UNDP Kosovë¹ - Ekipi i Projektit Pulsi Publik:

*Atdhe Hetemi,
Menaxher i Projektit Pulsi Publik*

*Iris Duri,
Statisticiente – Ekipi për politika, hulumtim, çështje gjinore dhe komunikim*

*Lektorimi dhe redaktimi i versionit në gjuhën angleze
Michelle O’Dea, Analiste e programit, Mjedisi dhe Energjia
Bardha Çunaj, Praktikante – Ekipi për politika, hulumtim, çështje gjinore dhe komunikim*

*Kontrolli i cilësisë,
Ekipi për politika, hulumtim, çështje gjinore dhe komunikim*

*Prishtinë
Prill 2015*

¹Për UNDP, referencat drejt Kosovës kuptohen të jenë në kontekst të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së (1999).

Dokumenti Pulsit Publik ofron një pasqyrë të saktë të treguesve kyç dhe rezultateve të Anketës së Pulsit Publik. Ky dokument përmbledhës përfshin periudhën nga nëntori 2014 deri në prill 2015 dhe ndjek traditën e raporteve të mëparshme duke shqyrtuar situatën e ndryshueshme në Kosovë në fushën politike, ekonomike, të sigurisë dhe zhvillimit. Përveç këtyre treguesve të rregullt kyç, ky numër gjithashtu paraqet disa vështrime lidhur me emigrimin e kohëve të fundit nga Kosova. Të dhënat shtesë të siguruar përmes këtij sondazhi do të jenë në dispozicion përmes Analizës së Pulsit Publik dhe Dokumentit të Veprimit.

Treguesit kryesor të Pulsit Publik

Kënaqshmëria me performancën e Institucioneve kosovare

Rezultatet e Anketës Pulsit Publik nga marsi 2015 tregojnë rënie të përgjithshme të kënaqshmërisë së njerëzve me punën e institucioneve kyçe ekzekutive, legjislative dhe gjyqësore të Kosovës. Një prej shpjegimeve të mundshme për pakënaqësinë e lartë me institucionet në nëntor 2014 ishte ngërçi politik i cili zgjati më shumë se tetë muaj. Sidoqoftë, të dhënat më të fundit tregojnë që pakënaqësia me institucionet mbetet e lartë, pavarësisht funksionimit të institucioneve që nga dhjetori i vitit të kaluar. Vetëm 21% e kosovarëve janë të kënaqur me institucionet kyçe të Kosovës krahasuar me 46% në prill të vitit 2014.

Më pak se 24% e kosovarëve kanë deklaruar se janë të kënaqur me punën e Kryeministrit

(krahasuar me 34% sa ishin në nëntor 2014 dhe 48.5% në prill të vitit 2014). Vetëm 18% e tyre kanë deklaruar se janë të kënaqur me punën e Institucioneve Qëndrore (krahasuar me 44% në prill të vitit 2014).

Sa i përket institucioneve legjislative, vetëm 19% e kosovarëve janë të kënaqur me punën e Kuvendit, ndërkaq 20% janë të kënaqur me performancën e Kryetarit të Kuvendit (krahasuar me 46.5% dhe 58% respektivisht gjatë prillit të vitit 2014). Edhe pse Presidentja gëzon nivelin më të lartë të kënaqshmërisë nga qytetarët, ky nivel i kënaqshmërisë gjithashtu ka pësuar rënie me kalimin e kohës. Anketat aktuale tregojnë se vetëm 30% e kosovarëve janë të kënaqur me punën e Presidentes (krahasuar me 40% në nëntor të vitit 2014). Presidentja, Kryetari i Kuvendit, Kryeministri dhe Institucionet Qëndrore kanë arritur nivelin më të ulët të kënaqshmërisë së qytetarëve që nga marsi i vitit 2007.

Niveli i kënaqshmërisë me Gjyqësorin gjithashtu nuk bën përjashtim në trendin në rënie me institucionet tjera kyçe. Niveli i kënaqshmërisë me punën e gjykatave kosovare dhe prokurorisë ka rënë me rreth 6 dhe 5 përqind respektivisht që nga nëntori i vitit 2014. Duhet theksuar se niveli i kënaqshmërisë me Gjyqësorin është më i ulëti në krahasim me të gjitha institucionet tjera, që tregon se humbja e besimit në zbatimin e ligjit ka ndikuar gjithashtu në nivelin e kënaqshmërisë me institucionet dhe fushat tjera. (shih Tabelën 1).

Tabela 1: Niveli i kënaqshmërisë me institucionet kyçe ekzekutive, legjislative dhe gjyqësore të Kosovës


		Mar-07	Maj-08	Qer-09	Prill-10	Nën-10	Qer-11	Tet-12	Prill-13	Prill-14	Nën-14	Mar-15
Kënaqshmëria me ekzekutivin	Institucionet qendrore	30.5%	46.9%	53.1%	29.2%	25.1%	32.6%	27.2%	27.0%	44.2%	19.3%	18.1%
	Kryeministri	54.0%	72.0%	53.8%	36.4%	30.7%	37.6%	27.3%	30.4%	48.5%	34.1%	23.6%
Kënaqshmëria me legjislativin	Parlamenti	31.0%	51.4%	53.2%	34.1%	32.1%	41.0%	32.1%	32.3%	46.5%	16.1%	19.3%
	Kryetari i Kuvendit	35.4%	56.5%	51.6%	36.0%	33.3%	60.9%	44.7%	45.8%	57.8%	23.3%	20.1%
	Presidenti	52.0%	74.0%	61.7%	54.9%	30.8%	54.1%	47.1%	45.1%	48.8%	40.7%	30.2%
Kënaqshmëria me gjyqësorin	Gjykata	20.0%	21.0%	32.7%	27.2%	18.5%	26.9%	24.3%	16.7%	37.5%	22.8%	17.2%
	Prokuroria	22.7%	22.7%	31.7%	26.9%	15.1%	20.0%	15.0%	17.7%	38.1%	21.0%	17.0%

Perceptimet mbi drejtimin politik dhe ekonomik

Pakënaqësia e kosovarëve lidhur me punën e institucioneve kyçe, gjithashtu pasqyrohet në nivelin e kënaqshmërisë me drejtimin politik në të cilin po shkon Kosova. Pak më shumë se 4% e kosovarëve janë ose të kënaqur ose shumë të kënaqur me drejtimin e tanishëm politik

të Kosovës (krahasuar me 21% në prill 2014). Shumica e respondentëve, (74%), deklarojnë se janë ose të pakënaqur ose shumë të pakënaqur me drejtimin e tanishëm politik të Kosovës (shih Figurën 1). (see Figure 1).


Figura 1: Kënaqshmëria me drejtimin politik të Kosovës



Afërsisht 39% të kosovarëve janë përgjigjur pozitivisht kur janë pyetur nëse janë të gatshëm të iu bashkohen protestave publike për arsye politike. Një përqindje pak më e lartë e shqiptarëve (45%), krahasuar me respondentët serbë

(41%), kanë pohuar se do të ishin të gatshëm të ju bashkohen protestave politike. Vetëm 30% e pjesëtarëve të grupeve të tjera etnike kanë deklaruar se do të protestonin kundër situatës aktuale politike (shih Figurën 2).


Figura 2: Përqindja e respondentëve që do t'ju bashkoheshin protestave publike kundër situatës aktuale politike



Si tregues për siguri, respondentët janë pyetur se a ndihen të sigurt apo të pasigurt në rrugë. Në këtë aspekt në përgjithësi ka një trend pozitiv, të dhënat nga marsi i vitit 2015 tregojnë se: 69% e kosovarëve ndihen të sigurt kur gjenden jashtë, ndërkaq rreth 24% (krahasuar me 26%

në nëntor të vitit 2014) ndihet përgjithësisht të pasigurt. Kur këto të dhëna janë analizuar në baza gjinore, nuk janë vërejtur dallime të mëdha ndërmjet përqindjes së grave dhe burrave që ndihen të sigurt kur gjenden në rrugë. (shih Figurën 3).


Figura 3: Siguria në gjatë qëndrimit jashtë shtëpisë



Rezultatet e sondazhit të opinionit publik të marsit 2015 tregojnë se Indeksi i Demokratizimit (ID) ka rënë për 0.11 pikë që nga nëntori 2014 në 0.98. Duke pasur parasysh që ID-ja mund të ketë vlerë nga 0 deri në 3, indeksi aktual tregon se shumica e njerëzve nuk kanë opinion pozitiv në lidhje me proceset demokratike

në Kosovë. Indeksi i Besueshmërisë Ekonomike (IBE) – i cili gjithashtu mund të ketë vlerë nga 0 deri në 3 – aktualisht është vlerësuar të jetë 0.80, që tregon se kosovarët kanë pikëpamje edhe më pesimiste për drejtimin ekonomik sesa për proceset demokratike. (shih Figurën 4).

Figura 4: Indekset e demokratizimit dhe besueshmërisë ekonomike²



²Shih faqen e fundit të dokumentit për më shumë informata rreth llogaritjes së indekseve

Për të përcaktuar se cilët faktorë kanë çuar në rënien e vlerës së indeksit, është kryer një analizë e trendit që krahason vlerat e treguesve që shfrytëzohen për krijimin e ID-së. Këto rezultate tregojnë se ka pasur rënie në vlerat e të gjithë komponentëve të indeksit. Përqindja e kosovarëve që besojnë se zgjedhjet në Kosovë janë demokratike dhe në harmoni me standardet ndërkombëtare ka pësuar rënien më të madhe nga të gjithë komponentët e ID-së, nga 34% sa ishte në nëntor të vitit 2014 në 26% në mars të vitit 2015.

Një tjetër komponent që ka treguar rënie të konsiderueshme është besimi i kosovarëve se institucionet e tyre qendrore e lokale janë duke iu përgjigjur nevojave dhe prioriteteve të qytet-

arëve të tyre. Në nëntor 2014, 18% e respondentëve besonin se Institucionet Qendrore Kosovare janë duke punuar sipas prioriteteve të qytetarëve kosovarë dhe 29.5% e respondentëve mendonin të njëjtën gjë për qeverisjet e tyre komunale. Anketa e fundit tregon se të dy këta komponentë kanë rënë me nga gjashtë pikë në përqindje.

Kosovarët gjithashtu kanë humbur besimin në lirinë e shprehjes së medieve dhe pavarësinë e sistemit gjyqësor. Vetëm 35.5% e respondentëve kanë pohuar se besojnë që Mediat në Kosovë gëzojnë lirinë e shprehjes krahasuar me 40% në nëntor 2014, ndërkaq 16% krahasuar me 13% sa ishin në nëntor 2014, kanë pohuar se besojnë në pavarësinë e sistemit gjyqësor. (shih Tabelën 2).

Tabela 2: Analizë e trendëve të komponentëve të Indeksit të Demokratizimit – Përqindja e përgjigjeve pozitive në pyetjet e Indeksit të Demokratizimit (përqindja e respondentëve që “pajtohen plotësisht” apo “kryesisht pajtohen”)

Kryesisht po dhe plotësisht po	Nën-10	Qer-11	Nën-11	Prill-12	Tet-12	Prill-13	Prill-14	Nën-14	Mar-15	Trend
A janë zgjedhjet në Kosovë demokratike dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare?	31.0%	29.3%	23.1%	17.0%	16.2%	15.0%	36.4%	34.0%	26.2%	
A e monitoron Kuvendi performancën e Institucioneve Qendrore?	20.7%	20.7%	19.4%	16.7%	17.7%	17.5%	28.5%	21.5%	21.2%	
A është sistemi i gjyqësorit në Kosovë i pavarur në vendimet që merr?	13.2%	15.6%	11.3%	12.3%	15.7%	10.6%	24.8%	16.0%	13.6%	
A gëzojnë mediat në Kosovë liri të shprehjes?	29.2%	33.9%	33.3%	34.7%	37.3%	24.6%	45.4%	39.6%	35.5%	
A shërben shoqëria civile në Kosovë si monitoruese e vërtetë e zhvillimeve demokratike në Kosovë?	22.6%	18.9%	20.3%	19.0%	24.4%	18.3%	28.8%	21.3%	19.5%	
A është duke punuar qeveria lokale e juaj (komuna) në përputhje me prioritetet e qytetarëve të Kosovës?	27.7%	26.7%	29.0%	25.7%	27.3%	26.1%	32.6%	29.5%	23.3%	
A janë duke punuar Institucionet Qendrore sipas prioriteteve të qytetarëve?	14.3%	16.1%	14.6%	12.9%	15.3%	16.4%	26.4%	18.2%	11.8%	
A janë kushtetuta dhe ligjet e Kosovës në fuqi demokratike dhe a i respektojnë të drejtat e njeriut?	32.6%	27.9%	26.5%	25.9%	26.0%	33.0%	35.3%	24.2%	23.5%	
Pavarësisht politikës ditore dhe duke shikuar përpara drejt të ardhmes, a pajtoheni se proceset demokratike në Kosovë janë institucionalizuar dhe janë duke shkuar në drejtimin e duhur?	25.6%	24.5%	17.9%	18.1%	18.6%	23.0%	33.0%	19.5%	17.3%	

Komponentët e IBE gjithashtu janë krahasuar me rezultatet e nëntorit 2014 për të kuptuar se cilët faktorë specifik kanë çuar në rënien e tij. Të dhënat tregojnë se të gjithë komponentët e indeksit kanë pësuar rënie krahasuar me sondazhin e kaluar. Përqindja e kosovarëve që besojnë se të hyrat e përgjithshme të familjes së tyre do të rriten në periudhë afatshkurtër (gjashtë muaj), ka pësuar rënien më të madhe krahasuar me treguesit tjerë të besueshmërisë

ekonomike; nga 20% në nëntor 2014 në 15% në mars 2015 (shih Tabelën 3). Vetëm 8% e kosovarëve mbajnë mendim të favorshëm për gjendjen aktuale të biznesit, ndërsa 5% mbajnë mendim të favorshëm lidhur me gjendjen aktuale të punësimit. Pjesa e kosovarëve që kanë pritje pozitive lidhur me gjendjen e punësimit në të ardhmen e afërt ka rënë në nivelin më të ulët që nga nëntori i vitit 2010 (shih Tabelën 3).


Tabela 3: Analiza e trendit në përqindje të përgjigjeve pozitive në pyetjet e komponenteve të IBE-së (përqindja e respondentëve që i konsiderojnë ato “të favorshme”)

Favourable	Nën-10	Qer-11	Nën-11	Pril-12	Tet-12	Pril-13	Pril-14	Nën-14	Mar-15	Trend
Çfarë janë pritjet tuaja në lidhje me të ardhurat totale të familjes suaj pas gjashtë muajsh?	16.8%	12.1%	8.5%	9.9%	9.6%	7.6%	17.0%	19.7%	15.1%	
Çfarë është vlerësimi juaj mbi kushtet aktuale të biznesit?	10.7%	9.7%	6.0%	7.9%	6.7%	4.8%	11.6%	8.8%	8.1%	
Çfarë është mendimi juaj mbi gjendjen aktuale të punësimit?	4.0%	3.3%	3.8%	3.4%	3.8%	5.1%	9.2%	7.7%	5.0%	
Çfarë janë pritjet tuaja lidhur me gjendjen e punësimit pas gjashtë muajsh?	14.3%	12.4%	8.0%	7.6%	7.4%	6.4%	13.7%	7.3%	6.0%	

Pakënaqësia publike me drejtimin ekonomik të Kosovës është edhe më e lartë se ajo me drejtimin e saj politik: rreth 31% e të gjithë respondentëve janë ose të pakënaqur ose shumë të pakënaqur me drejtimin aktual ekonomik të

Kosovës, ndërsa vetëm rreth 4% janë të kënaqur me të. Numri i atyre që janë të pakënaqur është edhe më i lartë tek komunitetet tjera (93.5%) krahasuar me shqiptarët (79%) dhe serbët (76%) (shih Figurën 5).

Figura 5: Niveli i kënaqshmërisë me drejtimin ekonomik të Kosovës




Perceptimet e problemeve kryesore

Më shumë se tri të katërtat e kosovarëve – 79% - mendojnë se problemet më të mëdha me të cilat përballet sot Kosova lidhen me gjendjen socio-ekonomike të tyre. Pesëdhjetë e dy përqind e respondentëve kanë zgjedhur papunësinë si problemin më të madh, të pasuar me 27% që kanë zgjedhur varfërinë. Korrupsioni

është renditur i treti në listë; 5% e kosovarëve mendojnë se ky është problemi më i madh në Kosovë. Këto shifra pjesërisht shpjegojnë arsyen për nivel të ulët të kënaqshmërisë me drejtimin ekonomik të Kosovës, Indeksin e ulët të Besueshmërisë Ekonomike. Përveç kësaj, respondentët mbesin të pabindur se në sektorin publik praktikohet punësimi i bazuar në merita (shih Figurën 6).


Figura 6; Perceptimet mbi problemet kryesore me të cilat përballet Kosova



Duke pasur parasysh se sektori publik është punëdhënësi më i madh në Kosovë, kjo shifër tregon pse respondentët janë aq pesimistë lidhur me gjetjen e vendit të punës në 6 muajt e ardhshëm (IBE me lartë). Shumica e kosovarëve (81%) besojnë se lidhjet familjare, rryshfeti, lidhjet partiake dhe bazat tjera jomeritore

janë faktorët më të rëndësishëm për t'u punësuar në sektorin publik. Vetëm rreth 15% të respondentëve besojnë se arsimi, përvoja profesionale dhe aftësimi profesional të kombinuarë së bashku ndihmojnë për të gjetur punë në sektorin publik (shih Figurën 7).

Figura 7: Perceptimet mbi meritokracinë në punësim në sektorin publik



Korrupsioni mbetet një nga tri problemet më të rëndësishme për kosovarët. Një numër i madh i respondentëve mendojnë që korrupsioni i shkallës së lartë është i përhapur në shumë institucione. Institucionet që shihen se kanë përhapjen më të lartë të korrupsionit përfshijnë: ofruesit e kujdesit shëndetësor 52% (krahasuar me 56% në nëntor të vitit 2014), Korporata Energjetike e Kosovës 45% (krahasuar me 39% në nëntor të vitit 2014), gjykatat 43%, Doga-

na 39% (krahasuar me 33% në nëntor të vitit 2014), administrata/institucionet qendrore 38.5%, Agjencia Kosovare e Privatizimit (37%), etj. Njëzet përqind e kosovarëve besojnë se korrupsioni i shkallës së lartë është i pranishëm në Policinë e Kosovës dhe Institucionet Ndërkombëtare, ndërkaq 24.3% (krahasuar me 17% në nëntor 2014) mendojnë që korrupsioni është i pranishëm në banka (shih Tabelën 4).

Tabela 4: Perceptimet mbi praninë e korrupsionit në shkallë të lartë në institucionet në Kosovë


	Nën-10	Qer-11	Nën-11	Pril-12	Shta-12	Pril-13	Pril-14	Nën-14	Mar-15	Trend
Shëndetësia (spitalet)	47.9%	40.7%	49.8%	43.3%	51.6%	50.4%	40.4%	56.2%	52.6%	
KEK	52.4%	47.9%	61.2%	47.8%	53.8%	48.8%	24.4%	39.1%	44.7%	
Gjykatat	49.7%	41.6%	55.6%	44.5%	47.5%	56.4%	32.2%	42.1%	42.9%	
Doganat	45.1%	42.3%	53.7%	43.2%	49.9%	58.9%	22.5%	33.4%	38.7%	
Institucionet qendrore	47.5%	41.4%	43.3%	39.5%	35.7%	46.1%	24.0%	37.5%	38.5%	
AKP (Agjencia Kosovare e Privatizimit)	52.0%	40.5%	51.9%	49.4%	46.4%	48.7%	24.6%	34.8%	37.1%	
Komunat (Qeverisja lokale)	32.9%	30.4%	31.9%	30.1%	32.2%	38.9%	20.6%	33.2%	33.8%	
Policia e EULEX-it (CIVPOL)	22.9%	26.2%	27.1%	28.3%	28.7%	38.3%	11.1%	16.5%	32.2%	
Arsimi (Shkollat, Univërsitetet)	14.4%	13.1%	17.3%	26.2%	23.5%	31.6%	13.0%	24.3%	29.3%	
ATK (Administrata Tatimore e Kosovës)		24.9%	36.5%	38.1%	33.6%	42.5%	16.5%	28.0%	28.1%	
PTK	34.0%	32.4%	46.6%	41.8%	45.1%	41.4%	15.4%	21.3%	25.9%	
Bankat	14.4%	14.9%	22.0%	20.5%	22.8%	37.5%	12.0%	17.0%	24.3%	
Organizatat ndërkombëtare	14.7%	12.3%	20.3%	19.3%	20.8%	24.8%	10.8%	16.2%	20.4%	
Policia e Kosovës (PK)	15.2%	15.5%	19.5%	19.4%	28.0%	30.3%	11.5%	16.1%	20.4%	

Perceptimet mbi diskriminimin

Nga respondentët është kërkuar që të shprehin mendimet e tyre në lidhje me atë se cilat grupe janë më të ekspozuara ndaj diskriminimit në Kosovë. Shumica e respondentëve kanë iden-

tifikuar grupet në vijim:, gratë/vajzat (24%), të moshuarit (23%), personat me aftësi të kufizuara (16%) dhe të rinjtë (shih Figurën 8).


Figura 8: Grupet që shihen si më të ekspozuarat ndaj diskriminimit në Kosovë



Në anketë respondentët gjithashtu janë pyetur nëse janë ndier të diskriminuar në ndonjë moment në të kaluarën e afërt dhe, nëse po, në çfarë baze. Kosovarët ndihen të diskriminuar kryesisht për këto arsye: opinionet politike apo të tjera (24%), arsye tjera ku përfshihen: vendbanimi, statusi refugjatë/i zhvendosur brenda

vendit/emigrant, statusi social, gjendja shëndetësore, etj. (22%), gjinia (21%) dhe mosha (17%). Një numër më i vogël i respondentëve u deklaruan se përkatësia etnike (5%), aftësia e kufizuar dhe gjuha (të dyja nga 3%) janë bazat më të shpeshta për diskriminim në Kosovë (shih Figurën 9).

Figura 9: Bazat për diskriminim ndër respondentë që janë ndier të diskriminuar në të kaluarën e afërme




Vala e fundit e migrimit në Kosovë

Emigrimi ka qenë tradicionalisht një mekanizëm me të cilin janë përballur kosovarët, prandaj gati gjysma e familjeve (47%) raportojnë se kanë anëtarë të familjes jashtë vendit. Sidoqoftë, gjatë gjashtë muajve të fundit, Kosova përballoi edhe një valë të papritur emigrimi. Më shumë se gjysma (50.5%) e respondentëve të sondazhit të fundit Pulsi Publik kanë pohuar se së paku një i afërm i tyre apo mik është larguar nga Kosova gjatë gjashtë muajve të fundit,

ndërkaq 49.5% kanë raportuar se së paku një anëtar i familjes së ngushtë (bashkëshort, prind, fëmijë, vëlla a motër, teze/hallë/dajë/axhë, nip a mbesë, familjarë të bashkëshortit apo bashkëshortes) ka migruar gjatë kësaj periudhe kohore (shih Figurën 10). Kur të dhënat për ata që janë larguar kategorizohen sipas gjinisë, del se 75% e tyre ishin meshkuj, ndërsa vetëm 25% ishin femra.


Figura 10: Marrëdhënia e respondentit me emigrantin



Shumica dërrmuese e respondentëve besojnë që arsyet kryesore për migrim nga Kosova gjatë gjashtë muajve të fundit lidhen me kushtet e varfërisë socio-ekonomike. Dyzet e pesë përqind besojnë se papunësia është arsyeja kryesore, 29% kanë zgjedhur varfërinë si arsye

kryesore, 10.5% vështirësitë ekonomike, ndërsa 10% janë përgjigjur se kosovarët janë duke migruar për të ndjekur një të ardhme më të mirë për familjet e tyre me të ardhura të ulëta (shih Figurën 11).


Figura 11: Sipas mendimit tuaj cila është arsyeja kryesore që njerëzit po migrojnë gjatë gjashtë muajve të fundit?



Për të pasur një pasqyrë për profilin e njerëzve që kanë migruar, respondentët janë pyetur lidhur me nivelin e arsimimit, punësimin dhe kushtet e jetesës së familjarëve, të afërmeve dhe miqve që kanë migruar gjatë gjashtë muajve të fundit. Të dhënat tregojnë që shumica e tyre³

(77%) kanë përfunduar shkollën e mesme, të pasuar nga ata që kanë përfunduar vetëm arsimin fillor (13%). Vetëm rreth 10% e atyre që kanë migruar – sipas miqve, të afërmeve dhe anëtarëve të familjes – kishin arsim universitar apo më të lartë (shih Figurën 12).

Figura 12: Niveli më i lartë i arritur në arsim tek migruerit (të moshës 18 vjeç a më shumë)




Ne gjithashtu kemi pyetur respondentët lidhur me statusin e punësimit të atyre që kanë migruar – gjatë kohës kur ata ishin në Kosovë. Bazuar në përgjigjet nga respondentët, shumica ishin të papunë dhe ishin në kërkim të vendit të punës (58%), të pasuar nga afër 20% që ishin studentë, amvise, të pensionuar apo me aftësi

të kufizuara. Rreth 11% e respondentëve familjarët, të afërmit apo miqtë e të cilëve kanë migruar, kanë raportuar se ata ishin duke punuar me orar të plotë para se të migronin, ndërkaq 7% ishin të punësuar me orar të shkurtuar. (shih Figurën 13).

³Shifra e llogaritur për migruerit e moshës 18 vjeç e më shumë.


Figura 13: Statusi i punësimit para emigrimit



Respondentët gjithashtu janë pyetur lidhur me standardin e jetesës së të afërmeve, miqve apo anëtarëve të familjes para se ata të largoheshin nga Kosova. Përmes figurës së mëposhtme e cila merr vlerat ndërmjet 1 (që tregon të hyrat më të ulëta dhe standardin më të ulët të jetesës) dhe 10 (të hyrat më të larta dhe standardin më të lartë të jetesës), mund të raportojmë se më

shumë se gjysma e atyre që kanë migruar gjatë gjashtë muajve të fundit (55%), kishin të hyra të ulëta dhe standard të ulët të jetesës (të vlerësuar si 1, 2 apo 3), gjatë kohës kur ishin në Kosovë. Ky grup pasohet nga rreth 42% e atyre që kishin të hyra dhe standard mesatar të jetesës (të vlerësuar si 4, 5 dhe 6) (shih Figurën 14).


Figura 14: Standardi i jetesës së emigrantëve para largimit



Kur janë pyetur për shtetin destinacion për ata që kanë migruar, 80% e respondentëve që pohanin se kishin familjarë, të afërm apo miq që kanë migruar, kanë raportuar se ata janë nisur

drejt Gjermanisë, të pasuar me 7.5% të atyre që janë nisur drejt Francës dhe rreth 3% që kanë preferuar Austrinë apo Zvicrën si destinacionin e tyre. (shih Figurën 15).


Figura 15: Cili ishte vendi i tij/saj/tyre i destinacionit?



Respondentët e Pulsit Publik gjithashtu janë pyetur lidhur me perceptimin e tyre për ndikimin e valës së fundit të migrimit në shoqërinë kosovare. Të gjeturat tregojnë se më shumë se gjysma (57%) e kosovarëve mendojnë që ndikimi i përgjithshëm është negativ, pasuar me 21% të cilët nuk janë përgjigjur në pyetje apo

kanë deklaruar se nuk dinë se çfarë ndikimi do të kishte. Një pjesë më e vogël e respondentëve (12%) mendojnë që kjo valë do të ndikojë pozitivisht dhe vetëm 10% konsiderojnë se vala e fundit e migrimit nuk do të ketë ndonjë ndikim në shoqërinë e Kosovës (shih Figurën 16).


Figura 16: Ndikimi i migrimit të fundit në shoqërinë e Kosovës



Në anën tjetër, një pjesë e madhe e kosovarëve (42%), besojnë që standardi i jetesës së emigrantëve jashtë vendit do të jetë më i mirë në krahasim me gjendjen e mëparshme në Kosovë. Sidoqoftë, 16% të respondentëve besojnë që standardet e jetesës së emigrantëve do

të jenë më të këqija apo do të mbesin të njëjta në vendet ku ata kanë migruar. Njëzet e gjashtë përqind e respondentëve nuk kanë pasur ndonjë mendim në lidhje me statusin e mundshëm të ardhshëm të emigrantëve (shih Figurën 17).


Figura 17: Perceptimet lidhur me standardin e jetesës së emigrantëve



Meqenëse migrimi po bëhet prapë temë shqetësimi – posaçërisht kur merren në konsideratë faktorët shtytës dhe pasojat për shkak të ilegalitetit – qytetarët janë pyetur nëse ata kanë ndonjë plan për të migruar nga Kosova. Gjetjet zbulojnë një pjesë të vogël të respondentëve që planifikojnë një gjë të tillë – 16% krahasuar

me 28% në nëntor të vitit 2014 – që është niveli më i ulët që nga nëntori i vitit 2010. Kjo shifër tregon se ata që më herët kishin plane të migronin mund të kenë bërë atë, ose që pjesa e kosovarëve që planifikojnë të migrojnë ka pësuar rënie gjatë gjashtë muajve të fundit (shih Figurën 18).

Figure 18: Planet për migrim




Sjellja e votuesve

Duke marrë në konsideratë kohëzgjatjen e ngërçit politik dhe ndikimin që e kishte në perceptimin e qytetarëve lidhur me drejtimin politik dhe atë ekonomik, qytetarët janë pyetur gjithashtu për qëndrimet e tyre ndaj votimit. Anketa e fundit tregon se qëndrimet e kosovarëve ndaj votimit janë goxha pesimiste, me një numër të konsiderueshëm të respondentëve

që besojnë se vota e tyre nuk mund të ndryshojë gjendjen në Kosovë (52% krahasuar me 45% në nëntor 2014), apo nuk dinë nëse vota e tyre mund të ndryshojë atë (21%). Vetëm 27% të votuesve potencial (krahasuar me 31% në nëntor të vitit 2014) besojnë që vota e tyre mund të ndryshojë gjendjen në Kosovë (shih Figurën 19).


Figura 19: Perceptimet mbi fuqinë e votës si mjet për ndryshimin e gjendjes aktuale politike në Kosovë



Pulsi Publik gjithashtu i ka pyetur respondentët lidhur me preferencat e tyre të votimit dhe gjetjet tregojnë se 35% të tyre (krahasuar me 29% në nëntor 2014) kanë deklaruar se do të votojnë për një parti të caktuar politike ose koalicion nëse mbahen zgjedhjet, ndërsa 9% kanë deklaruar se nuk kanë preferenca politike. Një

tjetër rezultat që shquhet më shumë në këtë pyetje është përqindja e lartë e atyre që deklaruan se nuk do të votojnë (20%, krahasuar me 17% në nëntor të vitit 2014) dhe e atyre që nuk janë përgjigjur fare në pyetje (36%, krahasuar me 40% në nëntor të vitit 2014) (shih Figurën 20).

Figura 20: Preferencat e votimit



Metodologjia

Këto rezultate janë bazuar në mostër të anketës me 1,306 qytetarë të Kosovës mbi moshën 18 vjeç, të të dyja gjinive dhe nga të gjitha komunat dhe rajonet e Kosovës, duke mbuluar zonat rurale dhe urbane. Mostra ka përfshirë 896 shqiptarë, 210 serbë dhe 200 pjesëtarë të pakicave joserbe të Kosovës (gjegjësisht turq, boshnjakë, goranë, romë, ashkali dhe egjiptianë). Metoda e anketimit është përmes mostrimit të rastësishëm të probabilitetit në shumë faza. Mostra është përfaqësuese e ekonomive familjare në Kosovë. Anketa është realizuar nga Index-Kosova (Prishtinë) gjatë fundit të marsit 2015.

Shënim për peshimin e totaleve

Anketat e realizuara për Pulsin Publik marrin mostra të tepërta të pakicave në mënyrë që të dhënat të mund të ndahen sipas përkatësisë etnike, megjithatë kur bëjmë përlllogaritjet për totale, peshimi bëhet sipas shifrave aktuale të popullatës.

Që nga viti 2002, për peshimin e totaleve në anketat tona për nivel të Kosovës janë shfrytëzuar përqindjet në vijim:

- Shqiptarë 88%
- Serbë 6%
- Komunitete të tjera (boshnjakë, turq, goranë, RAE) 6%.

Sidoqoftë, sipas regjistrimit të popullsisë dhe rezultateve zyrtare nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, përbërja etnike është si vijon:

Përkatësia etnike	Popullsia	Përqindja
Shqiptarë	1,616,869	92.93
Serbë	25,532	1.47
Turq	18,738	1.08
Boshnjakë	27,533	1.58
Romë	8,824	0.51
Ashkali	15,436	0.89
Egjiptianë	11,524	0.66
Goranë	10,265	0.59
Të tjerë	2,352	0.14
Gjithsej	1,739,825	100.00

Nëse do t'i aplikonim shifrat e mësipërme në anketat tona, peshimi do të ishte si në vijim:

- 93% shqiptarë
- 2% serbë
- 5% të tjerë.

Duke e pasur parasysh që serbët në pjesën veriore të Kosovës nuk kanë marrë pjesë në regjistrimin e popullsisë, së bashku me vështrimin e përgjithshëm që shkalla e pjesëmarrjes së serbëve në pjesën tjetër të Kosovës është më e ulët, ne kemi vlerësuar se duhet të shtojmë edhe 40,000 të tjerë për serbët, që arrin totalin prej 65,532. Kjo gjithashtu rritë numrin e përgjithshëm të popullsisë së Kosovës në 1,779,825.

Kur merren në konsideratë këto ndryshime, peshimi në anketat tona do të bëhet si në vijim:

- 92% shqiptarë
- 4% serbë
- 4% të tjerë (boshnjakë, turq, goranë, RAE).
- 4% Others (Bosnians, Turks, Gorani, RAE)

Përlllogaritja e indekseve

Indeksi i Demokratizimit është një mesatare e përbërë e bazuar në vlerësimin e respondentëve të nivelit të tyre të pajtimit apo mospajtimit lidhur me zhvillimin e proceseve të mëposhtme në Kosovë: zgjedhje të lira dhe të ndershme, monitorimi i performancës së institucioneve qendrore nga parlamenti, sistem i pavarur gjyqësor, liria e shprehjes dhe mediave, ekzistenca e një shoqërie civile mbikëqyrëse në Kosovë, institucione qendrore që funksionojnë në bazë të prioriteteve të qytetarëve, kushtetutë dhe ligje të bazuara në të drejtat e njeriut dhe nëse qeveritë lokale punojnë në përputhje me prioritetet e qytetarëve. Indeksi është vlerë e vazhdueshme e cila mund të ndryshojë nga 3 (maksimumi), që do të thotë se të gjithë respondentët pajtohen plotësisht se demokratizimi është në rrugën e duhur, deri në 0 (minimalja), që do të thotë se respondentët nuk pajtohen se demokratizimi është në rrugën e duhur.

Indeksi i besueshmërisë ekonomike është një mesatare e përbërë e cila përlllogaritet në bazë të vlerësimit të respondentëve për atë se sa të favorshme ose të pafavorshme janë kushtet aktuale ekonomike në Kosovë. Në mënyrë të veçantë, respondentët vlerësojnë kushtet në vijim: pritjet në lidhje me gjendjen e përgjithshme të të ardhurave dhe punësimit të familjes së tyre për gjashtë muajt e ardhshëm dhe vlerësimi i kushteve aktuale të biznesit dhe punësimit. Vlerat mund të jenë nga 0 (minimumi) deri 3 (maksimumi) ku vlerat nga 0-1.5 tregojnë vlerësim jo të favorshëm të gjendjes ekonomike ndërsa vlerat 1.5-3 tregojnë vlerësim kryesisht të favorshëm.